



REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Pranuar / Dorezuar Punë/Prodato Received/Delivered	29 . 12 3	viti god year
Organ /Njesia Organ /Jednica Org./Unit	Nr. Prot Br. Prot Prot No	Shtojca Pilog Appendix
SKOPS/SHCK	7747/2023	1/3



Republika e Kosovës Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.1351/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës–Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Jeton Koca-kryetar, Ardita Haxhnikaj–Demi dhe Eshref Shabani, anëtarë me Ardita Perçuku – Shyti, Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtëses, në procedurë sipas ankesës A.nr.1351/2023 të datës 30.10.2023 të parashtruar nga ankuesi kundër organit të punësimit/Komuna e Rahovecit, në çështjen juridike “Masë disiplinore” duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datën 28.12.2023, njëzëri mori këtë:

V E N D I M

- I. **Aprovohet** si e bazuar ankesa me numër A.nr.1351/2023, e datës 30.10.2023 e parashtruar nga ankuesi
- II. **Shfuqizohet** masa disiplinore “Vërejte me shkrim” me numër protokollit 5598, e datës 27.09.2023 e shqiptuar nga Drejtori i Drejtorisë për Buxhet dhe Financave në Komunën e Rahovecit.
- III. **Obligohet** Menaxheri i Personelit i Komunës së Rahovecit për zbatimin e këtij vendimi në afat prej pesëmbëdhjete (15) ditësh nga dita e pranimit të tij, duke larguar masën disiplinore nga dosja personale e ankuesit.
- IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim lidhur me veprimet e ndërmarra për zbatimin e këtij vendimi.

A r s y e t i m

Nëpunësi civil (me tej referuar: Ankuesi), më datë 30.10.2023 ka parashtruar ankesë me numër protokollit 6761 të regjistruar nën shenjen A.nr.1351/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër masës disiplinore “Vërejte me shkrim” me numër protokollit 5598 të datës 27.09.2023 të shqiptuar nga Drejtori i Drejtorisë për Buxhet dhe Financave në Komunën e Rahovecit, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të Ligjit të Punës

dhe Ligjit për Shërbimin Civil; Vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike; si dhe Zbatimit të gabuar të se drejtës materiale.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 31.10.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë në Komuna e Rahovecit, ndërsa kjo e fundit, më datë 08.11.2023 ka përcjell përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Kryearti i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me Vendim me numër protokolli 7440/2023 të datës 13.12.2023, ka zgjatur afatin për vendimmarrje edhe për dhjetë (10) ditë pune lidhur me ankesën A.nr.1351/2023 të datës 30.10.2023 të parashtruar nga ankuesi

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (me tej referuar: Kolegji i Këshillit) administroi këto prova: Ankesën A nr. 1351/2023 të datës 30.10.2023; Masën disiplinore të vërejtjes me numër protokolloi 5598 të datës 27.09.2023; Akt Emërimi me numër protokolli 2952 të datës 02.10.2017; Evidencën e vijueshmërisë në punë për periudhën 02.07.2023 deri me datë 31.08.2023; E-mailin e datës 03.11.2023; E-mailin e datës 18.12.2023; Përshkrimin e detyrave të punës; Akt Emërimin e datës 11.07.2023; Përgjigjen në ankesë me numër protokolli 3310 të datës 03.11.2023.

Kolegji i Këshillit duke u bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veç e veç dhe të gjitha provave të marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, konstatoi së ankesa e ankueses *është e bazuar, sepse:*

Nga administrimi i provave materiale të lëndës rrjedhë së ankuesi është i punësuar në Komunën e Rahovecit, respektivisht i njëjti sipas Aktit të Emërimit me numër portali 2952 të datës 02.10.2017 ushtron pozitën e punës "Zyrtar për Tatim në Pronë" në Sektorin e Tatimit në Pronë në Komunën e Rahovecit.

Me tej nga shkresat e lëndës rezulton se Drejtori i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, me datë 27.09.2023, ankuesit i ka shqiptuar masën disiplinore "Vërejtje me shkrim", me arsyetimin se nuk ka respektuar orarin e punës dhe nuk ka informuar për vonesat në punë dhe braktisjen e vendit të punës.

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, pretendon se masa disiplinore është shqiptuar në kundërshtim me legjislacionin në fuqi sepse sipas te njëjtit Drejtori i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa ka shqiptuar vërejtje me shkrim kinse për mosrespektimin e orarit të punës, ndërsa i njëjti nuk ishte prezent gjatë kësaj kohë.

Kolegji i Këshillit, në kuadër të autorizimeve kushtetuese dhe ligjore lidhur me sigurimin e respektimit të rregullave dhe parimeve që rregullojnë shërbimin civil, si dhe në kuptim të shqyrtimit të pretendimeve ankimore analizoi përshkrimin e detyrave të punës të ankuesit dhe si rrjedhojë konstatoi se i njëjti e ka statusin e nëpunësit civil dhe se për punën e tij i raporton drejtpërdrejt Shefit të Sektorit të Tatimit në Pronë. Rrjedhimisht, nga shkresat e lëndës, po ashtu rezulton se masa disiplinore ndaj ankuesit është shqiptuar nga Drejtori i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, i cili sipas legjislacionit në fuqi është i emëruar politik.

Kolegji i Këshillit, lidhur vërtetimin e kompetencës se organit administrativ për shqiptimin e masave disiplinore ju referua dispozitave të Ligji Nr.08/1-197 për Zyrtarët Publik, përkatësisht nenit 58 paragrafi 1 ku përcaktohet se: 1. *Masat disiplinore për shkeljet e lehta shqiptohen nga*



mbikëqyrësja/i i drejtpërdrejtë dhe/apo nga udhëheqësja/i më i lartë administrativ. 2. Masat disiplinore për shkeljet e rënda shqiptohen nga komisioni disiplinor, dhe si rrjedhojë konstatoi se për shkelje të lehta të detyrave të punës organ kompetent për shqiptimin e masës disiplinore është mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i nëpunësit civil apo udhëheqësi me i lartë administrativ.

Rrjedhimisht, bazuar në dispozitat përkatëse ligjore si dhe gjendjen faktike të vërtetuar si me lartë, Kolegji i Këshillit konstaton se në rrethanat e rastit konkret gabimisht është zbatuar ligji material ngase ankuesi sipas shkresave të lëndës akuzohej për shkelje të lehta të detyrave të punës, ndërsa masa disiplinore nuk është shqiptuar nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i tij, në këtë rast Shefi i Sektorit të Tatimit në pronë, ashtu sikurse as nga udhëheqësi me i lartë administrativ e që në rastin konkret është Kryetari i Komunës. Andaj, meqenëse masa disiplinore nuk është shqiptuar nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë apo udhëheqësi me i lartë administrativ, sikurse përcaktohet me nenin 58 paragrafi 1 të Ligji Nr.08/1-197 për Zyrtarët Publik, Kolegji i Këshillit konstaton se kjo masë disiplinore, ndaj ankuesit, është shqiptuar nga organi jo kompetent dhe për pasojë ky akt administrativ është i paligjshëm në kuptim të dispozitave të Ligji Nr.05/1-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, përkatësisht nenit 52 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 dhe 1.2 ku përcaktohet se: 1. Një akt administrativ është i paligjshëm nëse: 1.1. është nxjerre në mungesë të autorizimit nga një ligj; 1.2. organi publik që e nxjerr ka vepruar pa pasur kompetencë.


Andaj, duke marr për bazë konstatimin se akti administrativ i shqiptimit të masës disiplinore është i paligjshëm për shkak të shkeljeve procedurale, Kolegji i Këshillit nuk u lëshua në trajtimin e pretendimeve tjera ankimore ngase të njëjtat nuk do të kishin ndikim për vendosje ndryshe.

Kështu që, për sa me sipër dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 si dhe nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 dhe 1.6 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
Lënda: A.nr.1351/2023

Ardita Perçuku - Shyti


Procesmbajtëse



I dërgohet:

- Ankuesit
- Drejtorit të Drejtorisë për Buxhet dhe Financa në Komunën e Rahovecit;
- Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Rahovecit;
- Arkivit të KPMSHCK-së

